REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 397/21
Date/Datum. 31.05.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Basha	21.05. 2021	31.05.2021

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 11.05.2021, OE "Pharma Leader", ka parashtruar ankesë me nr: 397/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Meditech", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esenciale" (Lot 1 dhe 3), me nr. të prokurimit: 206-20-8397-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës:
Lot 1 - 1,239,245.44€.
Lot 3 - 4,851,824.16€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 12.12.2020, data e hapjes së ofertës: 05.01.2021, data e vendimit për dhënien e kontratës: 28.04.2021, data e njoftimit të me letër standarde: 28.04.2021.
Ankesa është e përsëritur.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2.PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues, ne ankesen e tij pretendon se AK-ja, me rastin e eliminimit nuk i ka respektuar ne teresi kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate dhe njeherit pretendon se i ploteson te gjithe kerkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate. Poashtu pretendon se AK-ja, me rastin e rivleresimit nuk e ka respektuar vendimin e PSH-se, nr: 240/21.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kapaciteti teknik dhe professional:
2. Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për

regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
2. Autorizimi për Marketing ne Kosovë, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë vlenë UA 02 2014 dhe per dëshmi - Kopja e Certificatës se Autorizim Marketingut ne një vend te BE (si dëshmi se produkti qarkullon ne BE).

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:
OE ankues është i papërgjegjshëm
OE i rekomanduar per kontratë është i përgjegjshëm

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1
Eksperti shqyrtues, sqaron se lidhur me kete aktivitet te prokurimit ka pasur ankese pikerishte nga OE ankues te cilit i eshte aprovuar ankesa si pjeserisht e bazuar dhe njeherit me vendimin nr: 240/21 te dates: 25.03.2021, autoriteti kontraktues eshte obliguar qe ti rivleresoj ofertat e OE-ve pjesemarres ne kete aktivitet te prokurimit.

Eksperti shqyrtues, sqaron se pas pranimit te vendimit te lartpermendur AK-ja, ka formuar komisionin per rivleresim te ofertave te cilet pas perfundimit te punes kan dhene rekomandimet e tyre, duke e eliminuar OE ankues me arsyetimin se:

- Nuk e keni plotesuar kriterin: 2. Kerkohet regjistrimi i barit - autorizimi per marketing nga AKPPM, me specifikimin e kerkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele te regjistruar ne Kosove, vlen UA 02 2014 per thjeshtimin e procedurave per regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kane paralele te regjistruara ne Republiken e Kosoves.

Eksperti shqyrtues, sqaron se edhe heren e pare, objekt i trajtimit ka qene kerkesa e lartshenuar per te cilen AK-ja ka konstatuar se OE ankues nuk e ka plotesuar kerkesen nr: 2 te FDT-se.

Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar kerkesen e dosjes se tenderit dhe te njoftimit per kontrate, ku eshte kerkuar:

Kërkohet regjistrimi i barit - autorizimi për marketing nga AKPPM, me specifikimin e kërkuar te produktit. Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014 Për thjeshtimin e procedurave për regjistrimin dhe importin e produkteve medicinale te cilat nuk kanë paralele te regjistruara ne Republikën e Kosovës.

OE ankues ne ankesen e tij pretendon se produkti i kerkuar nga AK-ja, eshte ne perputhje te plot me kerkesen e autoritetit kontraktues dhe njeherit pretendim kryesor tij eshte se produkti i ofruar nga OE ankues nuk ka paralele te regjtruar ne Kosove dhe njeherit lidhur me kete pretendim ka dhene edhe nje arsyetim profesional

te ankesen e tij te parashtruar ne OSHP, sipas te cilit produkti LISPRO ka ATC kodin A10AB04 dhe baze per prodhimin e kesaj insuline eshte Escheria Coli me teknologjine rekombinante te ADN-se, kurse produkti ASPART ka kodin ATC A10AD05 dhe baze per prodhimin e kesaj insuline eshte kerpurdha Saccharomyeses Cerevisiae me teknologjine rekombinante te ADN-se.

- Ne vazhdim eksperti shqyrtues, pasi ka prezatuar pretendimet e OE ankues, kerkesen e dosjes se tenderit, arsyen e eliminimit te OE ankues nga ana e autoritetit kontraktues, jep kete vleresim.

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne kerkesen e dosjes se tenderit vlereson se komisioni rivleresues fillimisht eshte dashur te vertetoj faktin se a ka te regjistruar paralele te produktit te ofruar nga OE ankues.
Autoriteti kontraktues, gjate fazes se vleresimit ka kerkuar sqarim me shkrim nga AKPM-ja, te cilet ne pergjigje ka deklaruar se: *"Ju lejohet importi i produktit me ATC Code A10AB04 dhe A10AD04 ne baze te udhezimit administrativ 02/2014* ***pasi qe ndryshon niveli i fundit i kodit ATC me produktet qe jane te regjistruara".***

Eksperti shqyrtues, vlereson se ankesa e OE ankues, eshte e bazuar per faktin se, duke u bazuar edhe ne sqarimin e AKPM-se, komisioni rivleresues per te ardh ne perfundim se produkti i ofruar nga OE ankues, a ka paralele te regjistruar ne Kosove, eshte dashur qe te vertetoj nje gje te tille sepse produkti i ofruar nga OE ankues sic eshte deklaruar edhe AKPM-ja, kan ATC kode te ndryshme me ato qe jane te regjistruara ne Kosove.

Duke u bazuar ne kerkesen e dosjes se tenderit eksperti shqyrtues, sqaron se pjesa e kerkeses se dosjes se tenderit ku thuhet: **Ne rast se nuk ka paralele të regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02 2014...** ka krijuar hapesire per interpretim dhe njeherit ekseprti shqyrtues sqaron se kerkesa e vendosur nga AK-ja, ne dosje te tenderit ka dy pjese.

Ne rastin konkrete, fakti qe OE ankues nuk ka ofruar AM, ateher autoriteti kontaktues, sic u sqarua edhe me larte eshte dashur verifikoje faktin se a ka paralele te regjistruar produkti i ofruar nga OE ankues dhe ne fund te nxjerr nje perfundim te sakte lidhur me kete ceshtje.

Poashtu eksperti shqyrtues, ka verejtur se komisioni rivleresues ne perberje te te cilit kan qene edhe dy Endokrinolog nuk eshte kontestuar cilesia e produktit te ofruar nga OE ankues dhe ne veqanti autoriteti kontaktues nder te tjera, ne pergjigjen e kerkeses per rishqyrtim ka deklaruar se: nuk e kontestojme kualitetin e produkteve te ofruara nga ana juaj, sidomos kur kihet parasysh se jane produkte te nje kompanie Amerikane sic eshte ELI LILLY.

Eksperti shqyrtues, kryesisht vjen ne perfundim se AK-ja, nuk e ka bere vleresimin e ofertave ne harmoni me nenin 59 te LPP-se, per faktin se pergijgja e AKPM-se, eshte se i lejohet importi i produktit me ATC kod A10AB04 ne baze te UA 02/2014, per faktin se ndryshon niveli i fundit te kodit ATC.
Andaj, bazuar ne kerkesen e dosjes se tenderit AK-ja, ka kerkuar qe produkti ne fjale ne rast se nuk ka paralele te regjistruar në Kosovë, vlenë UA 02/2014.

Ne fund eksperti shqyrtues, vlereson se AK-ja, perkatesisht komisioni vleresues duhet te kete parasysh ne teresi kerkesen e dosjes se tenderit dhe njeherit duke u bazuar edhe cmimin shume me te ulet te ofruar nga OE ankues (rreth 400,000.00€), atehere autoriteti kontaktues sipas dispozitave te nenit 1 dhe 6 te LPP-se dhe 72 te LPP-se obligohet qe te verifikoje produktin e OE ankues lidhur me ekzistencen e paraleles se produktit te ofruar nga OE ankues.

Pretendimi i OE ankues, se nuk eshte respektuar vendimi i PSH-se, nr: 240/21 i dates: 25.03.2021, qendron per faktin se kjo ceshtje eshte trajtuar edhe ne heren e pare dhe i njejti pretendim eshte konstatuar edhe nga paneli shqyrtues.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së për dhënie të kontratës per Lot 1 dhe 3 të refuzohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – MINISTRIA E SHËNDETËSISË.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - PHARMA LEADER.

PYTJA dhe ZËRAJTËRJA E DYTË

Besim Bajraktari

From: Fikrije Hoti
Sent: Friday, February 05, 2021 9:23 AM
To: Besim Bajraktari
Cc: Ardian Rugova; Arian Ahmeti; Ismet Hyseni
Subject: Sqarim Plotesues

Pershendetje,

Ju lejohet importi i produktit me ATC code A10AB04 dhe A10AD04 ne baze te UA 02/2014 pasiqe ndryshon niveli i fundit i kodit ATC me produktet qe te regjistruara.

Me respekt,
Fikrije Hoti

From: Besim Bajraktari
Sent: Friday, February 5, 2021 8:13 AM
To: Fikrije Hoti
Cc: Ismet Hyseni; Ardian Rugova; Arian Ahmeti
Subject: Sqarim Plotesues

Te nderuar,

Kerkesa per sqarimet e kerkuara konkretisht ka te beje me tenderin qe është ne procedure ne MSh me titull "Furnizim me Insulina Analoge nga Lista Esen
Nr. i prokurimit: 206-20-8397-1-1-1
Nr. i brendshëm: 206-20-67-111

Për Lot 1 - kemi pranuar produktin e regjistruar me ATC code A10AB05, si dhe produktin e pa regjistruar me ATC code A10AB04. A lejohet importi i produktit me ATC code A10AB04 ne baze te UA 02/2014.

Për Lot 3 - kemi pranuar produktin e regjistruar me ATC code A10AD05, si dhe produktin e pa regjistruar me ATC code A10AD04. A lejohet importi i produktit me ATC code A10AD04 ne baze te UA 02/2014.

PËRGJIGJA E PARË Ab

Besim Bajraktari

From: Fikrije Hoti
Sent: Wednesday, February 03, 2021 2:39 PM
To: Besim Bajraktari
Cc: Arian Ahmeti; Granita Selimaj; Ismet Hyseni
Subject: Sqarim !

Pershendetje,

Nese ATC Code i ketij produkti ne nivelin e 5-te te kodit te tij ndryshon me produktin medicional qe ka AM, ju lejohet importi i tij ne Kosove sipas UA 02/2014 .

Me respekt,

Fikrije Hoti
Zyrtar i Importit
Departamenti i Licencimit

AGJENCIA E KOSOVËS PËR PRODUKTE DHE PAJISJE MEDICINALE
Ministria e Shëndetësisë
Republika e Kosovës
Tel 038 200 24 278
Rrethi i Spitalit, QKUK, 10000 Prishtinë
Web: www.akppm.com

Konsideroni mjedisin para se ta shtypni këtë porosi elektronike

---

From: Arian Ahmeti
Sent: Wednesday, February 3, 2021 2:18 PM